

VENDIM
Nr. 22, datë 17.1.2024

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE
PUBLIKE PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2024, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për financat, Agjencia Shtetërore për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC) dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2024.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LIDHJA NR. 1
KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2024

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Janar	10	Ministria përgjegjëse për financat	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2025–2027
Janar	17	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2025–2027
Shkurt	8	SASPAC/KM	Përgatit dhe diskuton projektin e prioritetit të politikave 2025–2027 me ndikim në tavanet buxhetore.
Shkurt	14	Ministria përgjegjëse për financat	Paraqet në KM tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2025–2027, për fazën strategjike
Shkurt	28	KM	Miraton listën unike të projekteve me Rëndësi Kombëtare
Shkurt	28	Ministria përgjegjëse për financat	Dërgon udhëzimin e përgatitjes së buxhetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
Mars	8	KM	Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2025–2027
Mars–prill	1 mars–22 prill	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Përgatitin kërkesat e tyre buxhetore
Prill	24 prill–25 prill	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile për PBA 2025–2027
Maj	1	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Paraqesin në MF kërkesat e tyre buxhetore
Maj	2 - 17 maj	Ministria përgjegjëse për financat	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	2 - 17 maj	SASPAC/KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e prioritetit të politikave 2025–2027.
Maj	20 - 29 maj	Ministria përgjegjëse për financat	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Maj	30 - 31 maj	Ministria përgjegjëse për financat	Prezanton dokumentin e PBA 2025–2027 me shoqërinë civile
Qershor	3	SASPAC/KM	Përgatit dokumentin e rishikuar të prioritetit të politikave 2025–2027 me ndikim në tavanet buxhetore.
Qershor	3	Ministria përgjegjëse për financat	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e rregjuar)
Qershor	12	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar
Qershor	12	KM	Miraton dokumentin e rishikuar të prioritetit të politikave 2025–2027 me ndikim në tavanet buxhetore.
Qershor	13	Ministria përgjegjëse për financat	Përgatit dokumentin e PBA 2025–2027 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2025–2027.
Qershor	19	Ministria përgjegjëse për financat	Paraqet dokumentin e PBA 2025–2027 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2025–2027, për shqyrtim dhe miratim në KM.
Qershor	26	KM	Miraton dokumentin e PBA 2025–2027 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2025–2027
Korrik	5	Ministria përgjegjëse për financat	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2025–2027
Korrik	10	Ministria përgjegjëse për financat	Dërgon udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit në fazën teknike, në të gjitha Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Korrik–gusht	10 korrik–30 gusht	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Përgatitin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare
Shtator	2	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Paraqesin në MF kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	4-13	Ministria përgjegjëse për financat	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	3-13	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e rishikuar të prioritetit të politikave 2025–2027.
Shtator	16-24	Ministria përgjegjëse për financat	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Tetor	25 shtator–10 tetor	Ministria përgjegjëse për financat	Përgatit projektin buxhetor të vitit 2024, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2025–2027 dhe i paraqet për shqyrtim në KM.
Tetor	12	KM	Miraton projektin buxhetor të vitit 2024, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2025–2027
Tetor	19	Ministria përgjegjëse për financat	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2025–2027, të miratuar nga KM-ja
Tetor	19	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2025